



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.39, datë 25.04.2023

P Ë R

MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“KOMPLEKS HOTELERI, REZIDENCIAL DHE SHËRBIME
“LANA RIVERSIDE RESIDENCES”, ME VENDNDODHJE NË
BULEVARDIN “GJERGJ FISHTA”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 7, shkronja “ç”, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Forever Construction” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Kompleks hoteleri, rezidencial dhe shërbime “Lana Riverside Residences”, me vendndodhje në Bulevardin “Gjergj Fishta”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Forever Construction” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Vecantë, bashkëlidhen si pjesë përbërëse të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 19, datë 03.12.2020 “Për miratim e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Zhvillim kompleks për ndërtimin e ambjenteve të reja me funksion rezidencial dhe shërbimesh me 2, 4, 5, 7, 9, 11, 12 dhe 18 kate mbi tokë dhe 4 kate nëntokë, me vendndodhje në bulevardin “Gjergj Fishta”, Bashkia Tiranë”, shfuqizohet.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

